



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:908682

Datë: 05.02.2021

Numri i dokumentit: 01477629

**A.C.nr.1440/2018**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi, kryetar i kolegjit, Nehat Idriqi, dhe Burim Shala, anëtarë të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditësve A.M. dhe A.M.1 të dytë nga Fshati ..., Komuna Kaçanik, të cilët të dytë me autorizim i përfaqëson M.K – B., avokate me seli në Komuna Kaçanik, kundër të paditurës Komuna Kaçanik të cilën me autorizim e përfaqëson A.Z., juriste e diplomuar, lidhur me kompensimin e pronës në paluajtshmëri, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik, C.nr.142/2016 datë 15.02.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.02.2021, mori këtë :

## **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET e pathemeltë** ankesa e të paditurës Komuna Kaçanik, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik, C.nr.142/2016 datë 15.02.2018, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik, me aktgjykimin C.nr.142/2016 datë 15.02.2018, ndër të tjera ka vendosur si vijon :

*“...I. MIRATOHET, në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve A.M. dhe A.M.1, nga fsh. ... Komuna e Kaçanikut dhe DETYROHET e paditura Komuna e Kaçanikut, që paditësve të iña paguaj shumën prej 9.182.00€ për pjesën e përvetësuar të ngastrave kadastrale ... dhe ... dhe atë:*

*-Paditësit A.M. t'ia kompenzoj shumën prej 4.389.00€, (76m2x7.75€/m2), në emër të vlerës financiare për sipërfaqen e përvetësuar të një pjese të ngastrës kadastrale ..., Z.K. ... në sipërfaqe prej 76m2, e evidentuar në çertifikatën e pronës nr.....*

*Paditësit A.M.1 t'ia kompenzoj shumën prej 4.793.00€, (83m2x57.75€/m2), në emër të vlerës financiare për sipërfaqen e përvetësuar të një pjese të ngastrës kadastrale ..., Z.K. ... në sipërfaqe prej 83m2, e evidentuar në çertifikatën e pronës nr.....*

*Këto shuma me kamat në lartësi prej 8% duke filluar nga data 12.02.2018 (dt. E seancës kryesore) e deri në pagesën definitive.*

*II. DETYROHET, e paditura që paditësve të iña paguaj shumën në pikën I të këtij aktgjykimi, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1.672€, e cila pagesë do të bëhet në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit në dorëzim të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë...”.*

Kundër aktgjykimit C.nr.142/16 datë 15.02.2018, të marrë nga Gjykata Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik, në afat ligjor e paditura përmes të autorizuarit të saj, me datë 02.03.2018, ka paraqitur ankesë për shkak të: *shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta prish aktgjykimin ankimore apo çështjen ta kthej në riprocedur ose ta ndryshoj atë dhe ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit.

Përgjigje në ankesë kanë paraqitur paditësit përmes të autorizuarës së tyre, me të cilën përgjigje e ka konsideruar të pabazë ankesën e të paditurës me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta refuzoj në tërësi të pabazuar ankesën e të paditurës, ndërsa aktgjykimi i atakuar të mbetet në fuqi.

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, e ekzaminojë aktgjykimin e shkallës së parë brenda kufijve dhe shkaqeve të treguara në ankesa si dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore dhe gjeti se :

**- Ankesa është e pa themeltë.**

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësit A.M. dhe A.M.1 përmes të autorizuarës së tyre, me datë 09.09.2016, kanë paraqitur padi kundër të paditurës Komuna Kaçanik, lidhur me kompensim të paluajtshmërisë.

Gjykata e shkallës së parë, e ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor me datë 12.02.2018, dhe pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe administrimit të provave ka marrë Aktgjykimin C.nr.142/16 datë 15.02.2018, me të cilin e ka miratuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ndër të tjera ka arsyetuar se : *“...Gjykata kësaj ekspertize ja dha besimin, sepse e njehta është bërë konform nenit 15, 16 par 2 pika 2.1 si dhe nenit 32 të Ligjit nr.03/L-139 Ligji për shpronsimin e pasurisë së paluajtshme si dhe neneve 215 dhe 220 të LPJ – së. Meqenëse e paditura ka rënë në vonesë me kompenzimin e dëmit Gjykata me kërkesën e të autorizuarit të paditësve e detyroi të paditurën që paditësve në shumat e gjykuara t’ia paguaj edhe kamatën në lartësi prej 8%, duke filluar nga data 12.02.2018, e deri në ditën e pagesës definitive konform nenit 382 të LMD – së...”.*

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës Kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e Apelit vlerëson se sa i përket pretendimit ankimor se kemi të bëjmë me shkelje të procedurës, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, nuk ka

ndonjë pretendim konkret në të cilën është thirrur pala ankuese në ankesë, ndërsa nuk ka shkelje për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Në këtë çështje kontestimore nuk është kontestuese se paditësi A.M. evidentohen si posedues i ngastrës kadastrale nr...., Z.K. Kovaçec, në sipërfaqe prej 1643 m<sup>2</sup>, e cila evidentohet në certifikatën nr.29375/2016, Komuna Kaçanik, si dhe paditësi A.M.1 evidentohen si posedues i ngastrës kadastrale nr...., Z.K. Kovaçec, në sipërfaqe prej 76 m<sup>2</sup>, e cila evidentohet në certifikatën nr.79402/2016, Komuna Kaçanik, po ashtu nuk është kontestuese se gjatë zgjerimit të rrugës Kaçanik - Doganaj, paditësit A.M. i janë marrë nga ngastra kadastrale ..., 76 m<sup>2</sup>, ndërsa paditësit A.M.1 i janë marrë nga ngastra kadastrale ..., 83 m<sup>2</sup>, kjo vërtetohet nga ana e ekspertit të gjeodezisë M.S., dhe atë pa u zhvilluar procedura e shpronësimit.

Shuma e caktuar sipas raportit të vlerësimit nga eksperti i licencuar për vlerësim B.S., për kompensimin e pronës së marrë për paditësin A.M.1 është shuma prej 4.389.00 €, ndërsa për paditësin A.M. është shuma prej 4.793.00 €, dhe se shuma e llogaritur është reale dhe paraqet çmimin e tregut, dhe e paditura nuk ka pasur ndonjë propozim për nxjerrjen e provës përmes ri ekspertizës, si dhe nuk ka pasur vërejtje në provat e administruara nga Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur në Gjykatë me datë 12.02.2018.

Lidhur me pretendimin ankimor të të paditurës se për ndërtimin e trotuarit për këmbësor në ngastrat kadastrale që janë objekt i kësaj procedure kontestimore ka pasë pëlqimin e pronarëve të tokave, ky pretendim është i pa bazuar, pasi që paditura nuk ka prezantuar asnjë provë materiale se i është kompensuar paditësve prona e marrë për ndërtimin e trotuarit, dhe njëherit nuk ka prezantuar në Gjykatë asnjë provë se ka zhvilluar procedura administrative për shpronësimin e ngastrave kadastrale të cilat janë objekt i kësaj procedure kontestimore.

Në praktiken gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila në rastin Guiso-52Gallisay kundër Italisë në Aktgjykimin e 6 shtatorit 1978 ndër të tjera ka konstatuar se *"...Gjykata konsideron se ndërhyrja e ankimuar nga kërkuesit nuk ishte në përputhje me parimin e ligjshmërisë dhe kështu ka shkelur të drejtën e kërkuesve për gëzimin paqësor të pasurisë së tyre, si pasojë ka shkelje të Nenit 1 të Protokollit 1..."*, ndërsa në nenin 1 të Protokollit 1 të Konventes Evropiane për të drejtat e njeriut ndër të tjera thuhet se *"...Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare..."*.

Në nenin 46 par.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në mënyrë decisive thuhet se *"E drejta e pronës është e garantuar"*.

Andaj, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në këtë çështje civile-juridike, drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore dhe kështu Gjykata e kishte një pasqyrë reale mbi gjendjen faktike në këtë çështje juridike, për këto arsye aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara

Sa i përket vendosjes nga gjykata e shkallës së parë lidhur me shpenzimet e procedurës, nuk ka pasur pretendime ankimore.

Nga arsyet e cekura Gjkata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni/et 194, 195 paragrafi 1 pika (d), nenin 200 të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, nenin/et 46 par.1, dhe 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**A.C.nr.1440/2018 datë 04.02.2021**

**Kryetari i kolegjit - Gjyqtari,**  
**Bujar Muzaqi**